



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 706 Prot.

Tiranë, më 02.04 2026

URDHËR

Nr. 9 dt. 02.04 2026

“PËR

**FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT
TË ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT E STUDENTËVE TË FAKULTETEVE
DHE KËSHILLIN E STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT”**

Në zbatim të nenit 39 dhe 99 pika 1 dhe 3 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 23 dhe 96 të Statutit të UST-së, nenit 15 të Rregullores së UST-së, nenit 6, 7, 8, 9, 19, 25 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillave të Studentëve në Universitetin e Sporteve të Tiranës, shkresës nr.646 prot., datë 25.03.2026 të Këshillit Studentor me lëndë :“Vënien në dijeni për përfundimin e mandatit të Këshillave Studentor të UST-së”,

URDHËROJ :

1. Nisjen e procedurave për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, për krijimin e Këshillave të Studentëve të Fakulteteve dhe Këshillin e Studentëve të Universitetit, duke ndjekur hapat e mëposhtëm për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor.
2. Periudha e fushatës zgjedhore do të jetë nga **03.04.2026** deri më **04.05.2026**.
3. Çdo grup mësimor (seminari) në çdo Fakultet do të zgjedhë nga një përfaqësues në Asamblenë e Këshillit Studentor të Fakultetit. Votimi do të kryhet me shumicë të thjeshtë (50+1) në bazë të vetëkandidimit ose propozimit nga njëri- tjetri. Votimi do të kryhet në datat **07.05.2026** dhe **08.05.2026**.
4. Më pas Asambleja e Këshillit Studentor të çdo Fakulteti do të zgjedhë Këshillin Studentor të Fakultetit të përbërë nga 6 (gjashtë) anëtarë, me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Studentor të Fakultetit vetëkandidohen ose propozohen nga anëtarët e zgjedhur të Asamblesë së Këshillit Studentor të Fakultetit. Data e zgjedhjeve për Këshillat e Studentëve të Fakulteteve është **13.05.2026**.

5. Në mbledhjen e parë të Këshillit të Studentëve të çdo Fakulteti do të zgjidhet me shumicë të thjeshtë kryesia e Këshillit, e përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari.
6. Këshillat Studentorë të secilit fakultet të dalë nga zgjedhjet, në mbledhjen e parë, brenda një jave nga zgjedhja, duhet të zgjedhin kryesinë e këshillit të tyre, si dhe të zgjedhin nga një anëtar secili këshill, për formimin dhe konstituimin e Këshillit të Studentëve të UST.
7. Këshilli i Studentëve të çdo Fakulteti ka për detyrë të zgjedhë nga 1 (një) përfaqësues për çdo Fakultet, i cili do ta përfaqësojë në Këshillin e Studentëve të Universitetit.
8. Këshilli i Studentëve të Universitetit, përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, 3(tre) prej të cilëve *ex officio* pasi janë kryetarët e Këshillave të Studentëve të Fakulteteve dhe 3(tre) anëtarë të zgjedhur sipas pikës 7 të këtij Urdhëri.
9. E gjithë procedura e zgjedhjeve të organeve për çdo Këshill Studentor do të mbyllet brenda datës **18.05.2026**.
10. I gjithë procesi zgjedhor do të mbikqyret nga Komisioni i Marrëdhënive me Studentët.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Komisioni i Marrëdhënive me Studentët, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë, Publikun dhe Studentët, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore.
12. Ky urdhër i përcillet Administratorit të UST-së për mbështetjen me bazë materiale dhe financiare për zhvillimin e zgjedhjeve për Këshillat e Studentëve në UST.
13. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

